



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 549, datë 22.12.2022

“PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS SË GJYQTARIT {...} PËR VIJIMIN E USHTRIMIT
TË VEPRIMTARISË JASHTË FUNKSIONIT ME PAGESË ”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në Mbledhjen Plenare të datës 22.12.2022, si u njoh me materialet e çështjes, relacionin mbi projektvendimin “Për miratimin e kërkesës së gjyqtarit {...} për vijimin e ushtrimit të veprimtarisë jashtë funksionit me pagesë”, përgatitur nga relatorja znj. Brikena Ukperaj, si dhe pasi shqyrtoi propozimin e Komisionit për Vlerësimin e Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, bazuar në kërkesën e gjyqtarit {...} me nr.6186 prot., datë 02.12.2022,

VËREN:

I. FAKTET E ÇËSHTJES

1. Z. {...}, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, aktualisht ushtron veprimtari këshillimore pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në Strasburg. Kjo veprimtari është lejuar me vendimin nr. 121, datë 29.03.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ku është disponuar: “Miratimin e kërkesës së z. {...}, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për ushtrimin e veprimtarisë së paguar jashtë funksionit, të këshillimit ligjor pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Strasburg, me shkëputje nga ushtrimi i detyrës së gjyqtarit, për periudhën 04.04.2022 deri 01.07.2022...”.

2. Para përfundimit të afatit të ushtrimit të veprimtarisë së paguar jashtë funksionit, nga ana e gjyqtarit është paraqitur kërkesa për dhënien e lejes së veçantë të papaguar, për punësim të përkohshëm në pozicionin e këshilltarit ligjor pranë GJEDNJ Strasburg, për periudhën 1 korrik 2022 deri në dhjetor 2022. Lidhur me këtë kërkesë Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr.238, datë 30.06.2022 ka vendosur: “Miratimin e kërkesës së z. {...}, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për vijimin e ushtrimit të veprimtarisë së paguar jashtë funksionit, të këshillimit ligjor pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Strasburg, me shkëputje nga ushtrimi i detyrës së gjyqtarit, për periudhën 02.07.2022 deri në 31.12.2022...”.

3. Në datën 02.12.2022, me nr. 6186 prot., është regjistruar në Këshillin e Lartë Gjyqësor kërkesa e gjyqtarit për miratimin e lejes së paguar për të qenë në dispozicion të Gjykatës së

Strasburgut për periudhën 01.01.2023 deri në datë 31.12.2023.¹ Në kërkesën e tij z. {...} parashtron se gjatë periudhës së atashimit (të qenit në dispozicion) si këshilltar ligjor pranë GJEDNJ, për shkak të nevojës dhe ngarkesës që ka Gjykata Evropiane për çështjet që kanë të bëjnë me Shqipërinë, i është propozuar nga autoritetet respektive pranë Gjykatës, për të vijuar atashimin (qenien në dispozicion), në cilësinë e këshilltarit ligjor “seconded”, për periudhën 01.01.2023 deri në 31.12.2023. Po ashtu, parashtrohet se kjo veprimtari nuk paguhet nga GJEDNJ, sepse duhet të mbulohet nga ana e vendeve anëtare, pasi nga ana e Këshillit të Evropës ai do të përfitojë vetëm mbështetje financiare me dietat e nevojshme të jetesës për shkak të ndryshimit të madh të nivelit të jetesës dhe shpenzimeve në shtetin pritës.

4. Sa i përket motivit mbi të cilin bazohet kërkesa për miratimin e ushtrimit të kësaj veprimtarie, në kërkesën e tij z. {...} parashtron, ndër të tjera, se: “... *veprimtaria e zhvilluar do të konsistojë në këshillimin ligjor pranë Gjykatës së Strasburgut, për trajnimin e çështjeve që kanë të bëjnë me Shtetin Shqiptar, një veprimtari plotësisht e pajtueshme me atë të magjistratit në kuptim të nenit 53 të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar*” si dhe e mbështet kërkesën në interesin për zhvillimin dhe thellimin e njohurive në fushën e Konventës Evropiane të Drejtave të Lirive Themelore të Njeriut, e cila ka një status ligjor si e drejtë ndërkombëtare në nivel kushtetues ose pas kushtetues, çka do të përbënte një përvojë të rëndësishme në karrierën dhe formimin e tij profesional.

5. Gjyqtari i ka bashkëlidhur kërkesës së tij letër referencën e autoriteteve të GJEDNJ me nr.#7504466, datë 29 nëntor 2022, nëpërmjet të cilës parashtrohet se: “... *Kontributi i z.{...} në përpunimin e çështjeve në lidhje me Shqipërinë dhe njohurit e tij të përditësuara mbi të drejtën shqiptare kanë qenë shumë të çmuara për Regjistrin dhe Gjyqtarët e Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut. Ai punon shumë efektivisht dhe këshillat e tij janë vlerësuar shumë nga juristët e tjerë të Regjistrit. Z.{...} ka shprehur dëshirën për të zgjeruar punën e tij në Regjistrin përtej datës së fundit aktuale të vendosjes së tij. Ai ka në plan të vazhdojë detyrën e tij aktuale dhe në të njëjtën kohë të kryejë kërkime mbi aspektet praktike të marrëdhënieve midis gjykatave shqiptare dhe rasteve të Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut.....Do të ishim shumë të kënaqur nëse autoritet shqiptare do t'i mundësonin z.{...} të vazhdonin punën e tij në Gjykatë siç u shpjegua më sipër, në bazë të një atashimi. Kushtet e një atashimi të tillë do të duhej të pajtoheshin midis z.{...} dhe autoritetit të tij të vendit, brenda dispozitave të Rezolutës...”.*

II. PROCEDURA E ZHVILLUAR

6. Komisioni për Vlerësimin e Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me qëllim trajtimin e kërkesës së gjyqtarit {...}, duke iu referuar parashikimeve të nenit 9, të ligjit nr. 96/2016

¹ Me email-in e datës 06.12.2022, protokolluar në Këshill me nr. 6186/1Prot, datë 07.12.2022 gjyqtari ka saktësuar datën e përfundimit të lejes së kërkuar, nga data 12.12.2023 në datën 31.12.2023.

“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, administroi të dhënat e vëna në dispozicion bashkë me kërkesën dhe mendimin e zëvendëskryetarit të gjykatës, lidhur me funksionalitetin.

7. Në datë 07.12.2022, me nr. 6186/2 prot., është dërguar prej gjyqtarit mendimi i zëvendëskryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër mbi kërkesën e z. {...}, nëpërmjet shkresës me nr. 1583 prot., datë 07.12.2022. Në këtë akt, zëvendëskryetari i Gjykatës, në referim të parashikimeve të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, jep pëlqimin e tij për miratimin e kërkesës për dhënie leje për gjyqtarin {...}, për t’u angazhuar si këshilltar ligjor pranë GJEDNJ.

8. Pas shqyrtimit në mbledhjen e datës 15.12.2022, KVEVP vendosi që kjo çështje t’i kalojë për shqyrtim Mbledhjes Plenare.

9. Çështja u morr në shqyrtim në mbledhjen plenare të Këshillit më datë 22.12.2022, brenda afatit 3 javor, në referim të parashikimeve të pikës 6 të nenit 9 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

III. KUADRI LIGJOR I ZBATUESHËM

10. Neni 9 i ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, lidhur me veprimtaritë jashtë funksionit të magjistratëve, parashikon se:

1. Magjistrati lejohet të kryejë veprimtari jashtë funksionit, vetëm nëse këto veprimtari:

a) janë në përputhje me dinjitetin e ushtrimit të funksionit;

b) nuk krijojnë perceptime të ndikimit ose njëanshmëri gjatë ushtrimit të funksionit;

c) nuk bien ndesh me interesat thelbësorë të funksionit, duke mos cenuar afatet dhe ushtrimin në mënyrë eficiente të funksioneve;

ç) nuk bien ndesh me qëllimin për të cilin është ulur ngarkesa e punës;

d) në rast se shpërblimi për veprimtaritë jashtë funksionit përfshin çdo lloj dhe formë pagese, shpërblim financiar ose kompensim, të cilat nuk tejkalojnë rregullat e zakonshme të tregut;

dh) nuk janë të papajtueshme me ushtrimin e funksionit të magjistratit dhe nuk ndalohen sipas këtij ligji.

2. Me përjashtim të botimeve shkencore ose trajnimeve, magjistrati ndalohet të përdorë titullin e magjistratit në veprimtaritë jashtë funksionit, si dhe merr masa që palët e treta të mos e përdorin titullin e tij në këto veprimtari.

3. Magjistrati mund të shkruajë, të publikojë, të japë leksione dhe mësimdhënie për çështjet ligjore dhe të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me çështje ligjore, sistemin ligjor, administrimin e drejtësisë dhe çështje të tjera të lidhura me to, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni.

4. Magjistrati, para se të fillojë kryerjen e një veprimtarie të paguar jashtë funksionit, sipas përcaktimeve të këtij neni, duhet të njoftojë Këshillin dhe t'i paraqesë dokumentacionin e nevojshëm që:

a) përshkruan natyrën dhe kohëzgjatjen e këtyre veprimtarive;

b) vërteton masën e shpërblimit të këtyre veprimtarive;

c) evidenton ngarkesën në punë në gjykatë ose prokurori, ngarkesën totale të punës në gjykatë ose prokurori, si dhe përmbushjen në kohë të detyrave përgjatë 12 muajve të mëparshëm.

5. Magjistrati merr miratimin e Këshillit përkatës, përpara se të pranojë kryerjen e veprimtarive të paguara jashtë funksionit.

6. Këshilli vendos brenda tri javëve nga marrja e kërkesës dhe e dokumentacionit të plotë dhe jep miratimin nëse veprimtaria dhe çdo shpërblim për kryerjen e saj janë në përputhje me pikën 1 të këtij neni. Në rast se Këshilli brenda afatit 3-javor nga marrja e kërkesës dhe e dokumentacionit të plotë nuk shprehet me vendim, nuk njofton të interesuarin, si dhe nuk merr vendimin për zgjatjen e afatit, kërkesa konsiderohet e aprovuar, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative.

7. Magjistrati, pa cenuar afatet e përcaktuara dhe ushtrimin në mënyrë efikente të funksioneve, mund të marrë pjesë në veprimtari të papaguara jashtë funksionit, pa miratimin e Këshillit, vetëm në rastet kur:

a) vepron si përfaqësues i gjyqësorit ose prokurorisë;

b) merr pjesë në aktivitete për çështje të lidhura me sistemin gjyqësor ose të prokurorisë dhe bën deklarata publike të përgjithshme në kuadër të pjesëmarrjes në këto aktivitete;

c) merr pjesë në diskutime për çështje të ligjit.

8. Magjistrati raporton, brenda 6-mujorit të parë të vitit pasardhës, në Këshill, për veprimtaritë e papaguara jashtë funksionit, ku ka qenë i përfshirë në vitin paraardhës.

9. Brenda muajit janar të çdo viti, Këshillat publikojnë në faqen zyrtare, si dhe i dërgojnë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe organeve të administratës tatimore një raport me shkrim të arsyetuar për veprimtaritë jashtë funksionit të paguara të magjistratëve, duke përcaktuar pagesën ose shpërblimin e përfituar gjatë vitit paraardhës dhe vlerën përkatëse të tregut. Institucionet përkatëse bashkëpunojnë me Këshillat për përcaktimin e vlerave normale të tregut.

10. Bazuar në parimin e barazisë dhe të proporcionalitetit, Këshilli miraton rregulla të detajuara për veprimtaritë jashtë funksionit.

IV. ANALIZA LIGJORE E ÇËSHTJES

11. Pavarësisht se objektin e kërkesës gjyqtari e titullon “Kërkesë për leje të paguar”, në thelb kërkesa e tij drejtuar Këshillit, i referohet miratimit të një veprimtarie jashtë funksionit me pagesë që ai do të kryejë, veprimtari e cila konsiston në ofrimin e këshillimit ligjor pranë GJEDNJ-së. Në këtë kuadër, duke konsideruar natyrën e veprimtarisë që kërkohet të ushtrohet të njëjtë me ato të miratuara me herët nga Këshilli me vendimet nr.121, datë 29.03.2022 dhe nr.238, datë 30.06.2022, kërkesa e tij u trajtua në përputhje me

nenin 143 të Kushtetutës, si dhe nenin 9 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim “Ligji për Statusin”).

12. Lidhur me veprimtaritë jashtë funksionit, në nenin 143 të Kushtetutës parashikohet se: “Qenia gjyqtar nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër politike ose shtetërore, si dhe veprimtari profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës, me përjashtim të aktivitetit mësimdhënës, akademik, shkencor, si dhe delegimit pranë institucioneve të sistemit të drejtësisë, sipas ligjit”. Në nenin 9 të Ligjit për Statusin, parashikohet se magjistratit i lejohet të kryejë veprimtari jashtë funksionit, me ose pa pagesë, vetëm nëse këto veprimtari përmbushin kushtet si më poshtë:

- a) janë në përputhje me dinjitetin e ushtrimit të funksionit;
- b) nuk krijojnë perceptime të ndikimit ose njëanshmëri gjatë ushtrimit të funksionit;
- c) nuk bien ndesh me interesat thelbësorë të funksionit, duke mos cenuar afatet dhe ushtrimin në mënyrë efiçiente të funksioneve;
- ç) nuk bien ndesh me qëllimin për të cilin është ulur ngarkesa e punës;
- d) në rast se shpërblimi për veprimtaritë jashtë funksionit përfshin çdo lloj dhe formë pagese, shpërblim financiar ose kompensim, të cilat nuk tejkalojnë rregullat e zakonshme të tregut;
- dh) nuk janë të papajtueshme me ushtrimin e funksionit të magjistratit dhe nuk ndalohen sipas këtij ligji.

13. Sa i përket veprimtarive të paguara jashtë funksionit, në pikën 5 të nenit 9, të Ligjit për Statusin, parashikohet marrja e miratimit nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, para se magjistrati të pranojë kryerjen e saj. Ndërkohë në pikën 4, të nenit 9 përcaktohen dokumentet që duhet të shoqërojnë kërkesën me shkrim të magjistratit dhe të dhënat e domosdoshme që ato duhet të përmbajnë me qëllim vlerësimin mbi bazueshmërinë e kërkesës për dhënie miratimi për ushtrimin e veprimtarisë konkrete.

14. Në lidhje me procedurën dhe element të tjerë që kanë të bëjnë me trajtimin e kërkesës për ushtrimin e veprimtarisë jashtë funksionit, në pikën 10 të nenit 9, të Ligjit për Statusin, parashikohet se: “Bazuar në parimin e barazisë dhe të proporcionalitetit, Këshilli miraton rregulla të detajuara për veprimtaritë jashtë funksionit”. Këshilli aktualisht nuk ka miratuar rregulla të detajuara për veprimtaritë jashtë funksionit të gjyqtarëve. Për pasojë, kërkesa e z. {...} u trajtua në përputhje me parashikimet e nenit 143 të Kushtetutës, nenit 9 të Ligjit për Statusin, duke pasur në vëmendje parimet e proporcionalitetit dhe barazisë.

15. Miratimi i kërkesës për ushtrimin e një veprimtarie jashtë funksionit, me ose pa pagesë, bëhet pas verifikimit dhe vlerësimit të kushteve të përgjithshme, të parashikuara në nenin 9 pika 1 të Ligjit për Statusin. Ndërkohë për ushtrimin e veprimtarive të paguara jashtë funksionit, kërkesa me shkrim, bazuar në parashikimet e nenit 9, pika 4 të Ligjit për Statusin, duhet të shoqërohet edhe me të dhëna apo dokumentacion lidhur me (i) *përshkrimin e natyrës dhe kohëzgjatjes së veprimtarisë;* (ii) *masën e shpërblimit të këtyre*

veprimtarive dhe (iii) ngarkesën në punë të gjyqtarit si dhe përmbushjen në kohë të detyrave përgjatë 12 muajve të mëparshëm.

16. Në rastin konkret, lidhur me plotësimin e kushteve si më sipër, si dhe paraqitjen e të dhënave dhe dokumentacionit të nevojshëm për vlerësimin e bazueshmërisë së kërkesës, rezulton si vijon :

16.1 Gjyqtari {...} ka paraqitur kërkesë me shkrim në datë 02.12.2022, me nr. 6186 prot., saktësuar dhe plotësuar me kërkesën me nr. 6186/1 prot., datë 07.12.2022, duke kërkuar miratimin e Këshillit për ushtrimin e veprimtarisë së këshilltarit ligjor pranë GJEDNJ, si i atashuar (qenien në dispozicion), “seconded” duke përcaktuar edhe periudhën e ushtrimit të veprimtarisë nga data 01.01.2023 deri në datë 31.12.2023;

16.2 *Kërkesa përmban përshkrimin e veprimtarisë jashtë funksionit për të cilën kërkohet miratimi, si dhe përshkrimin konkret të detyrave kryesore që përfshin ushtrimi i veprimtarisë së këshilltarit ligjor pranë GJEDNJ. Gjyqtari ka referuar në kërkesën me shkrim, duke e shoqëruar atë dhe me dokumentacionin e nevojshëm, se natyra e veprimtarisë e cila synohet të ushtrohet konsiston kryesisht kryerjen e detyrave këshillimore për Regjistrin dhe Gjyqtaret e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Strasburg të tilla si hartimin e shënimeve të gjyqtarit të vetëm, raportet e komunikimit dhe projekt-vendimet.*

16.3 *Veprimtaria jashtë funksionit që kërkohet të ushtrohet në rastin konkret, është në përputhje me parashikimet e nenit 9, pika 1, shkronja a) të Ligjit për Statusin pasi, referuar natyrës së saj, rezulton se ajo përbën një veprimtari e cila nuk cenon dinjitetin e funksionit të magjistratit. Po ashtu referuar qëllimit të kësaj veprimtarie, që konsiston në kryerjen e detyrave këshillimore, kërkimin ligjor, hartimin e raportimeve dhe opinioneve ligjore, trajnimin praktik dhe të çështjeve konkrete, kjo veprimtari qartësisht përbën një veprimtari e cila është në përputhje me parashikimet e nenit 143 të Kushtetutës dhe nenit 9, pika 1 të Ligjit për Statusin;*

16.4 *Veprimtaria në rastin konkret, duke konsideruar natyrën dhe qëllimin e saj, nuk krijon asnjë perceptim të ndikimit ose njëanshmërisë në ushtrimin e funksionit gjyqësor, pasi veprimtaria këshillimore pranë një gjykate ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, jo vetëm që nuk krijon objektivisht dhe as potencialisht ndonjë perceptim për njëanshmëri apo ndikim për ushtrimin e funksionit gjyqësor, por përkundrazi përbën një vlerë të shtuar në formimin profesional të magjistratit, e cila do të përkthehet në sjelljen e një përvojë specifike dhe të dobishme për sistemin gjyqësor shqiptar, duke krijuar njëkohësisht edhe hapësirë për të dhënë një kontribut profesional dhe dinjitoz pranë organizatës ndërkombëtare në të cilën ai do të ushtrojë këtë veprimtari;*

16.5 *Gjatë kryerjes së saj veprimtaria e këshilltarit ligjor nuk bie ndesh me interesat thelbësore të funksionit dhe nuk cenon ushtrimin në mënyrë eficiente të detyrës së gjyqtarit,*

pasi në rastin konkret, për shkak të vendit në të cilin do të ushtrohet kjo veprimtari (jashtë territorit shqiptar) si dhe natyrës së veprimtarisë e cila, për periudhën përkatëse është me kohë të plotë, ajo do të pasjellë ndërprerjen e përkohshme të ushtrimit të funksioneve gjyqësore të gjyqtarit pranë Gjykatës ku ai ushtron funksionin aktualisht. Për pasojë, gjatë ushtrimit të kësaj veprimtarie, e cila nuk do të zhvillohet paralelisht me funksionet gjyqësore pranë Gjykatës në të cilën ai është i caktuar në mënyrë të përhershme, ajo nuk mund të ndikojë në afatet dhe eficientësinë e ushtrimit të detyrës së gjyqtarit;

16.6 *Veprimtaria nuk bie ndesh me qëllimin për të cilin është ulur ngarkesa e punës*, pasi në rastin konkret, sikurse u analizua më sipër, gjatë periudhës 12 mujore në të cilën gjyqtari do të ushtrojë veprimtarinë jashtë funksionit, nuk do të ushtrojë paralelisht funksionet gjyqësore, dhe për pasojë, nuk gjen aplikim ulja e ngarkesës në punë. Në rastin konkret, për shkak të lejes për ushtrimin e veprimtarisë së paguar jashtë funksionit të miratuar me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 121, datë 29.03.2022 dhe nr.238, datë 30.06.2022, z. {...} ka ndërprerë përkohësisht ushtrimin e funksionit të gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe çështjet që ai ka pasur në shqyrtim prej datës 04.04.2022, janë rishpërndarë me short mes trupës gjyqësore të kësaj gjykate;

16.7 *Veprimtaria që gjyqtari do të ushtrojë është një veprimtari e paguar*, por që përmban disa specifika.

16.7.1 Konkretisht, në bazë të Rezolutës CM/Res(2012)2, datë 15.02.2012, *zyrtarët e transferuar do të qëndrojnë në punë ose do të paguhen nga shteti anëtar nga i cili ai/ajo është dërguar gjatë gjithë periudhës së dërgimit dhe nuk do të marrin asnjë rrogë nga Këshilli i Evropës*. Kjo rezolutë është e mbështetur në nenin 16 të Statutit të Këshillit të Evropës, akt i ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, duke u bërë pjesë e sistemit të brendshëm sipas nenit 122² dhe 5³ të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në nenin 16 të Statutit të Këshillit Evropës parashikohet se: *“Komiteti i Ministrave, në përputhje me dispozitat e neneve 24, 28, 30, 32, 33 dhe 35, në lidhje me kompetencat e Asamblesë Konsultative, vendosin me fuqi detyruese të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me organizimin dhe rregullimet e brendshme të Këshillit të Evropës. Për këtë qëllim, Komiteti i Ministrave miraton rregullime të tilla financiare dhe administrative siç mund të jetë e nevojshme”*. Pra, rezoluta parashikon qartë mbulimin e pagesës së nëpunësit të atashuar, nga shteti anëtar nga i cili nëpunësit janë dërguar, gjatë gjithë periudhës së dërgimit. Në kuadër të këtij detyrimi, organet e shtetit shqiptar, pa përjashtim, kanë detyrimin për të vijuar me pagesën e

²Neni 122: 1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetë zbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji. Ndryshimi, plotësimi dhe shfuqizimi i ligjeve të miratuara me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit për efekt të ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare bëhet me të njëjtën shumicë.

2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të.

3. Normat e nxjerra prej një organizate ndërkombëtare kanë epërsi, në rast konflikti, mbi të drejtën e vendit, kur në marrëveshjen e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë për pjesëmarrjen në atë organizatë, parashikohet shprehimisht zbatimi i drejtpërdrejtë i normave të nxjerra prej asaj.

³Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të.

nëpunësve të cilët atashohen derisa këta vazhdojnë periudhën e atashimit pranë organeve të Këshillit të Evropës. Kjo do të thotë se përgjatë periudhës së atashimit të gjyqtarit pranë Gjykatës së Strasburgut, duhet të vijojë të paguhet nga gjykata respektive, në përputhje të plotë me të drejtën ndërkombëtare për Republikën e Shqipërisë, si një detyrim ky që është i zbatueshëm në rastin konkret.

16.7.2 Në kushtet kur gjyqtari nuk do të marrë një pagesë për punën e kryer nga Këshilli i Evropës dhe do të vijojë të trajtohet me pagën për funksionin e gjyqtarit nga gjykata përkatëse, nuk ka vend për vlerësimin nëse ky trajtim tejkalon rregullat e zakonshme të tregut, në kuptim të nenit 9, pika 1, shkronja d) të Ligjit për Statusin.

16.8 Sipas akteve të administruara në kuadër të trajtimit të kësaj kërkesë, rezulton se nga ana e Këshillit të Evropës gjyqtari do të trajtohet me pagesë vetëm në formën e dietës që përfshin shpenzimet e jetesës për shkak të ndryshimit të nivelit të jetesës dhe shpenzimet në shtetin pritës, shpërblime të cilat, pavarësisht se nuk ka të dhëna për masën e tyre, vlerësohet se nuk përbëjnë trajtim financiar të diferencuar, për sa kohë që nga natyra e tyre konsistojnë në mbulimin e kostove të jetesës dhe nuk përbëjnë të ardhura apo shpërblim për ushtrimin e funksionit.

17. Veprimtaria e këshilltarit ligjor të atashuar pranë GJEDNJ-së, është e papajtueshme me ushtrimin e funksionit të magjistratit dhe po ashtu nuk përbën veprimtari të ndaluar sipas Ligjit për Statusin. Veprimtaritë e papajtueshme dhe ato të ndaluara për magjistratët, parashikohen në mënyrë të detajuar në nenet 6, pika 1⁴ dhe 7, pika 4⁵ të Ligjit për Statusin. Në rastin konkret, duke iu referuar (i) natyrës së institucionit pranë të cilit magjistrati do të atashohet; (ii) veprimtarisë së këtij institucioni që konsiston në veprimtari gjyqësore në fushën e të drejtave të njeriut; (iii) natyrës së punës apo veprimtarisë që magjistrati do të kryejë sipas përshkrimit të saj, referuar akteve të administruara bashkëlidhur kërkesës dhe (iv) qëllimit të kësaj veprimtarie konkrete; nuk ka asnjë të dhënë që të krijojë dyshime se veprimtaria konkrete mund të përmbajë elementë që bien ndesh me parashikimet e nenit 6

⁴Në nenin 6 të ligjit nr. 96/2016 të titulluar “Papajtueshmëritë me funksionin e magjistratit”, në pikën 1, parashikohet se “1. Funksioni i magjistratit është i papajtueshëm me: a) anëtarësinë në parti politike dhe pjesëmarrjen në veprimtari politike të organizuara nga një parti politike; b) kryerjen e çdo veprimtarie politike, pavarësisht nëse veprimtaria kryhet në bashkëpunim me ndonjë parti politike ose jo, që mund të ndikojë në pavarësinë e magjistratit, të krijojë ndonjë konflikt interesi ose, në çdo rast, të krijojë përshtypjen që magjistrati është i paanshëm dhe i pandikuar.”.

⁵Në nenin 7, pika 4 të ligjit nr. 96/2016, parashikohet se: “4. Magjistratit i ndalohet: a) të administrojë, të drejtojë ose të ushtrojë ndikim në shoqëritë tregtare ose fitimprurëse, personalisht ose nëpërmjet përfaqësimit; b) të zotërojë në mënyrë aktive aksione ose pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit; c) të zotërojë në mënyrë pasive aksione ose pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare, nëse shoqëria ka fitime ose të mira nga kontratat publike, në përputhje me legjislacionin për parandalimin e konfliktit të interesit në fuqi; ç) të zotërojë në mënyrë pasive aksione ose pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare, në të cilën veprimtaria e magjistratit është e ndaluar, për shkak se mund të ndikojë në pavarësinë e magjistratit, krijon konflikt interesi ose krijon përshtypjen që magjistrati është i njëanshëm ose i ndikuar; d) të jetë ekspert në gjykatat vendase ose arbitër në arbitrazhin tregtar”.

dhe 7 të Ligjit për Statusin, që parashikojnë rastet e papajtueshmërisë me funksionin e magjistratit dhe kufizimet për shkak të funksionit.

18. Sa i përket cenimit të funksionalitetit të gjykatës, sipas mendimit të kryetarit të dërguar me shkresën nr. 1583 prot., datë 07.12.2022, rezulton se ndërprerja e ushtrimit të funksioneve e gjyqësore të gjyqtarit {...} pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, nuk cenon funksionalitetin e gjykatës, edhe pse ngarkesa e kësaj gjykate, siç parashtrohet në këtë akt, është e lartë për shkak të numrit të reduktuar të gjyqtarëve efektivë. Referuar mendimit të kryetarit, rezulton se pavarësisht ngarkesës së gjykatës, numri i gjyqtarëve që ushtojnë funksionin pranë kësaj gjykate, miratimi i kërkesës së gjyqtarit {...} për vijimin e lejes për t'u angazhuar si këshilltar ligjor pranë GJEDNJ nuk do të sjellë pasoja në funksionalitetin e saj. KVEVP, i vetëdijshëm për ngarkesën e përgjithshme aktualisht të të gjitha gjykatave, në vlerësimin lidhur me cenimin e funksionalitetit të gjykatës, në rastin konkret, veç sa më sipër, merr në konsideratë edhe (i) nevojën për të pasur ekspertizën vendase në GJEDNJ si dhe (ii) të drejtën e magjistratit për të zhvilluar karrierën e tij dhe për të zgjeruar dhe përditësuar dijet nëpërmjet veprimtarive dhe angazhimeve profesionale të pajtueshme me funksionin, duke synuar të krijojë një balancë sa më të drejtë mes nevojave të gjykatës dhe të drejtës së gjyqtarit për të ushtruar veprimtarinë konkrete, në respektim të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit.

19. Për sa më sipër rezulton se kërkesa e gjyqtarit {...} për ushtrimin e veprimtarisë jashtë funksionit, të këshillimit ligjor pranë GJEDNJ-së, për një periudhë tjetër tashmë deri në 12 muaj, përmbush kriteret ligjore të përcaktuara në nenin 9, të ligjit nr. 96/2016, si dhe përbën veprimtari e cila është në përputhje me parashikimet e nenit 143 të Kushtetutës.

20. Sa i përket çështjeve gjyqësore, për shkak të disponimit të Këshillit me vendimin nr. 121, datë 29.03.2022, nëpërmjet të cilit krahas miratimit të kërkesës për ushtrimin e veprimtarisë jashtë funksionit për gjyqtarin, është disponuar edhe për rishpërndarjen me short të çështjeve që gjyqtari ka pasur në shqyrtim, në momentin që veprimtaria objekt shqyrtimi në këtë akt do të fillojë të ushtrohet, gjyqtari nuk do të ketë çështje në shqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe për pasojë, nuk ka vend për disponimin mbi mënyrën e procedimit të tyre.

V. KONKLUZIONI

21. Për sa arsyetohet më lart, Këshilli vlerëson se kërkesa e gjyqtarit {...} për vijimin e ushtrimit të veprimtarisë së paguar jashtë funksionit, në cilësinë e këshilltarit ligjor në dispozicion, pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Strasburg, me shkëputje nga ushtrimi i detyrës së gjyqtarit, për periudhën 01.01.2023 deri në 31.12.2023, përmbush kushtet ligjore sipas parashikimeve të nenit 9 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe si e tillë duhet të pranohet. Në lidhje me të drejtën e ankimit, në referim të parashikimeve të nenit 100 të Ligjit

nr.115/2016 ndryshuar me ligjin nr. 47/2016, kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

PËR KËTO ARSYE:

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 61 dhe 68 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 9, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së z. {...}, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për vijimin e ushtrimit të veprimtarisë së paguar jashtë funksionit, të këshillimit ligjor pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Strasburg, me shkëputje nga ushtrimi i detyrës së gjyqtarit, për periudhën 01.01.2023 deri në 31.12.2023.
2. Periudha e ushtrimit të veprimtarisë së paguar jashtë funksionit, të këshillimit ligjor pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Strasburg, përbën vjetërsi në detyrë si magjistrat.
3. Gjatë kohës së ushtrimit të veprimtarisë së paguar jashtë funksionit në cilësinë e këshilltarit ligjor në dispozicion, gjyqtari do të përfitojë pagën, si dhe do t’i paguhen kontributet e detyrueshme mbi të për sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe për pension suplementar.
4. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtarit {...} dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.
5. Ngarkohet Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër për zbatimin e pikës 3 të këtij vendimi.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (*pesëmbëdhjetë*) ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR